

AKTI I THEMELIMIT
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“SABO” SH.P.K., DATE 28.08.2023

Sot, në datën 28.08.2023, **Z. Orgest Birçaj**, shtetas shqiptar, lindur më 15.05.1983, lindur në Vlorë dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit pasaporte nr. BE25550690 dhe nr. personal I30515124P dhe **Z. Ermir Alija** shtetas shqiptar, lindur më 31.12.1986, në Tiranë dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit ID nr.032756881 dhe nr. Personal I61231027R, në cilësinë e Ortakëve Themelues, vendosën themelin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar të emërtuar “SABO” Shpk. Kjo shoqëri do të realizojë veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, Aktin e Themelimit dhe Statutin, i cili i bashkëlidhet këtij Akt – Themelimi, si Shtojca A.

NENI 1 – EMËRTIMI

- 1.1 Shoqëria emërtohet “SABO” Shpk.

NENI 2 – FORMA

- 2.1 Shoqëria “SABO” Shpk themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij Akti Themelimi dhe Statutit të saj.
2.2 Shoqëria vepron në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi.

NENI 3 – SELIA

- 3.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Rruga “Sulejman Delvina”, nd.13, Pasuria nr. 5/6-N1, Zona kadastrale 8270, Vol.18, fq.154 hyrja 1, kt.4, Njësia Bashkiake nr.5 Tirane, Shqipëri, 1001.
3.2 Shoqëria mund të ketë zyra, degë, zyra përfaqësimi dhe agjenci në adresë të tjera si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj.
3.3 Asambleja e Përgjithshme mund të çelë, transferojë dhe/ose mbyllë, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, degë dhe/ose zyra përfaqësimi dhe/ose njësi vendore të çdo lloji, ndërsa, Administratori i Shoqërisë mund të çelë dhe/ose transferojë dhe/ose mbyllë adresë sekondare të ushtrimit të veprimtarisë, filiale dhe/ose agjenci.

NENI 4 – OBJEKTI

4.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë konsiston ne:

- Grumbullim, përpunim, eksport dhe tregtim me shumice e pakice te bimëve medicinale, produkteve dhe nënprodukteve bujqësore, blegtorale dhe pyjore.
- Grumbullim, përpunim dhe tregtim i te gjitha llojeve te metaleve, lende te pare ndërtimi, mineraleve dhe te te gjitha llojeve te metaleve me ngjyre dhe pa ngjyre.
- Prodhim, grumbullim, përpunim dhe tregtim te te gjitha llojeve te inerteve, lende te pare ndërtimi, import eksport i tyre.
- Dhënia me qira e materialeve te ndërtimit, skela, makineri etj.
- Projektim dhe/ose ndërtim, të objekteve social - kulturore, ekonomike, industriale, rezidenciale etj.
- Tregtim i pajisje hidraulike, pajisje hidrosanitare dhe aksesorëve të tyre, si edhe të gjithë materialeve, të cilët janë të përdorshme dhe lidhen me fushën e ndërtimit.
- Import dhe tregtim me shumice e pakice i makinerive dhe pajisjeve të ndryshme industriale, si edhe të pjesëve këmbimit për to.
- Servis automjetesh, duke përfshirë ato industriale dhe të tjera;
- Transport kombëtar dhe ndërkontrollor mallrash dhe/ose pasagjeresh për vete dhe tretë.
- Veprimitari hoteliere, bar-bufe, restorant.
- Veprimitari ne fushën e realizimit të punimeve të ndërtimit, duke përfshirë zbatimin vetë dhe/ose përmes kontraktimit të të tretëve, investimin, zhvillimin përmes sipërmarrjeve në ndërtim;
- Prodhim, tregimi(shit-blerje) i materialeve te ndërtimit, import – eksportin e tyre brenda dhe jashtë vendit për vete dhe të tretë.
- Veprimitari ne fushën e turizmit, duke synuar ndërtimin dhe shfrytëzimin e strukturave akomoduese, veprimitarive të tjera në fushën e hotelerisë dhe rezidencave turistike te pushimeve, qendrave të argëtimit, të cilat përfshijnë organizimin dhe ofrimin e veprimitarive artistike, kulturore, sportive, rekreative, retreat-eve etj. brenda dhe jashtë vendit;
- Investimet në fushën e programeve renting(qiradhënie/ marrje) të strukturave që përshtaten për qëllime pushimi/ turistike, duke i blerë, marrë me qira, ndërtuar ose përfituar nga pjesëmarrja në investime me partnerë/ të tretë dhe shfrytëzimi ekonomik i tyre përmes

qiradhënieve dhe/ ose ofrimit të shërbimeve të tjera të hotelerisë/ strukturave akomoduese dhe shërbimeve plotësuese në fushën e turizmit.

- *Gjithashtu, shoqëria mund te kryeje çdo aktivitet tjetër plotësues dhe ndihmës qe ka si qellim ofrimin e çdo aktivitetit tjetër, ne rast se rezultojnë te dobishme dhe/ose te nevojshme për përbushjen e objektit kryesor, si dhe çdo aktivitet tjetër qe konsiderohet fitimprurës dhe ne interes te shoqërisë.*

NENI 5 – KOHËZGJATJA

- 5.1 Shoqëria themelohet me një kohëzgjatje të pakufizuar.
- 5.2 Shoqëria mund të prishet në çdo moment me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

NENI 6 – KAPITALI I SHOQËRISË, KONTRIBUTET DHE KUOTAT

- 6.1. Kapitali i Shoqërisë është 1'000'000 Lekë (një milion lekë), i përbërë nga 2 (dy) kuota, zotëruar ortakët themelues Z. Orgest Birçaj, 1(një) kuotë, në masën 50% (pesëdhjetë përqind), dhe Z. Ermir Alija, 1(një) kuotë, në masën 50% (pesëdhjetë përqind) të kontributit në kapitalin e shoqërisë.
- 6.2 Kuotat e Ortakut/ve të Shoqërisë janë lirisht të transferueshme sipas legjislacionit tregtar në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- 6.3 Kapitali i Shoqërisë është nënshkruar dhe zotërohet nga Ortakët Themelues, themelues Z. Orgest Birçaj, në masën 50% (pesëdhjetë përqind), dhe Z. Ermir Alija në masën 50% (pesëdhjetë përqind), të kontributit në kapital.
- 6.4 Secili nga Ortakët e Shoqërisë përgjigjet për detyrimet kundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të saj.

NENI 7 – TRANSFERIMI I KUOTAVE

- 7.1 Kuotat e Shoqërisë mund të transferohen, tërësisht apo pjesërisht, sipas procedurës së përcaktuar në Statutin e Shoqërisë dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.

NENI 8 – ADMINISTRATORI/ËT



- 8.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë Administratorë. Në rast se ka më shumë se një Administrator, Administratorët do të veprojnë bashkërisht, me përjashtim të rastit

kur parashikohet ndryshe në aktin e emërimit të tyre. Administratori/ët do të qëndrojë/në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje ose për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me mundësi rizgjedhje. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr vendim përpara mbarimit të afatit në detyrë, mandati i tyre do të rinovalitet automatikisht edhe për një vit tjeter.

- 8.2 Administratori/ët përfaqëson ligjërisht Shoqërinë. Administratori ushtron të gjitha të drejtat dhe kompetencat e administrimit të zakonshëm të Shoqërisë, në përputhje me nenin 95 të Ligjit nr.9901, datë 14 mars 2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe çdo rast në zbatim të kufijve të përcaktuar në aktin e emërimit të tij dhe/ose në Statutin e Shoqërisë.
- 8.3 Administratori/ët mund të emërojë përfaqësues me prokurë të posaçme (“ad negotia”) për kryerjen e një veprimi ose disa veprimeve, në kufijtë e tagrave që i/u janë dhënë nga ligji, statuti dhe/ose akti i emërimit.
- 8.4 Caktohet si Administratori i parë i Shoqërisë:

Z. Ermir Alia shtetas shqiptar, lindur më 31.12.1986, në Tiranë dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit ID nr.032756881 dhe nr. Personal I61231027R

Specimeni i Firmës së Administratorit të Parë të Shoqërisë është si më poshtë:

Emër Mbiemër	Nënshkrimi
	

NENI 9 – GJUHA

- 9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 2(dy) kopje në gjuhën shqipe.




NENI 10 – DISPOZITA TË FUNDIT

10.1 Për çdo çështje që nuk rregullohet posaçërisht nga ky Akt - Themelimi, do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar.

* * *

“SABO ”sh.p.k.

ORTAKËT THEMELUES:


ORGEST BIRÇAJ

ERMIR ALIA
